

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2009

LËNDA: NJOHURI PËR SHOQËRINË

VARIANTI A

E premte, 10 korrik 2009

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11	12	13	14	15a	15b	16	17a	17b	17c
Pikët										
Kërkesa	18	19	20							
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.Anëtar

2.Anëtar

1. Gjatë periudhës shumëshekullore të pushtimit të Shqipërisë nga Turqia, kultura përparimtare shqiptare është zhvilluar si: **1 pikë**
- A) nënkulturë
B) kundërkulturë
C) ksenocentrizëm
D) difuzion
2. Divorci dhe rimartesa që pasojnë njëra-tjetrën si dukuri sot quhen: **1 pikë**
- A) monogami seriale
B) poligami seriale
C) endogami
D) ekzogami
3. Të dhënat historike tregojnë se në procesin e zhvillimit të kulturës: **1 pikë**
- A) janë shtuar nxitjet agresive të njerëzve, por janë bërë më të njerëzishme marrëdhëniet ndërmjet tyre
B) janë pakësuar nxitjet agresive të njerëzve, por marrëdhëniet ndërmjet tyre nuk janë shumë të njerëzishme
C) janë pakësuar nxitjet agresive të njerëzve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre janë shumë të njerëzishme
D) janë shtuar nxitjet agresive të njerëzve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre nuk janë shumë të njerëzishme.
4. Gjени në cilin prej komunikimeve mesazhet bëhen gjithnjë e më pak personale. **1 pikë**
- A) Ndërpersonal
B) Në grupe
C) Masiv
D) Vetvetor
5. Personaliteti i çdo njeriu përfshin mënyrat si ai: **1 pikë**
- A) mendon për vete dhe për botën
B) reagon emocionalisht në situata të ndryshme
C) vepron në jetën e përditshme
D) të gjitha të mësipërmet.
6. Teknologjia moderne ndryshon nga shkenca sepse: **1 pikë**
- A) zhvillohet me metoda kërkimore sistematike
B) mund të arrijë rezultate duke u mbështetur vetëm në përvojën praktike
C) është mjet për zbatimin në praktikë të parimeve shkencore
D) të gjitha të mësipërmet.
7. Ekologjia urbane shpreh: **1 pikë**
- A) punën e shkencëtarëve për të minimizuar ndotjet e mëdha të mjedisit
B) bashkëveprimin e mjedisit fizik dhe të jetës shoqërore në qytete
C) shkencën që studion shkaqet e ndotjes së mjedisit
D) A dhe C.

8. Një ndër format më të skajshme të paragjyqimeve është:

1 pikë

- A) fanatizmi
- B) racizmi
- C) intoleranca
- D) paragjykimi institucional.

9. Detyrimi i organeve ekzekutive është:

1 pikë

- A) të miratojë ligje në përputhje me kushtetutën
- B) të sigurojë zbatimin e ligjit
- C) të vendosë drejtësi në rastet e shkeljes së ligjit
- D) të gjitha detyrimet e mësipërme.

10. Funksionimi i demokracisë kërkon që:

1 pikë

- A) pushteti politik të përqendrohet në dorën e një institucioni kushtetues më të rëndësishëm në një vend
- B) pushteti politik të përqendrohet në dorën e një personi të vetëm me shumë autoritet
- C) pushteti politik të mos jetë i përqendruar në dorën e një institucioni të vetëm
- D) A dhe B

11. Cilat vlera dallohen si më origjinale në kulturën shqiptare?

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

12. Vendndodhja gjeografike e Shqipërisë, shturja e mëvonshme e rendit feudal në Shqipëri, qenia e tri besimeve të mëdha fetare në Shqipëri, pushtimet e shumta dhe qenia e zonave të lira, janë disa nga faktorët më veprues që kanë ndikuar në ekzistencën e një mozaiku të larmishëm nënkulturash në Shqipëri? Listoni tre të tjera:

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

13. Ndikimi jo shumë i ndjeshëm i shtypit deri në fillimet e shekullit XX përcaktohej nga tri rrethana shoqërore dhe kulturore. Shkruani ato.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

14. Shkruani tre nga funksionet e fesë:

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

15. Në sociologji:

a) Martesa përcaktohet si _____ **1 pikë**

b) Familje quhet _____ **2 pikë**

16. Cilat janë teoritë kryesore që shpjegojnë devijancën? **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

17. Në studimet e proceseve urbane:

a) Krijimi i vendbanimeve të përhershme quhet _____ **1 pikë**

b) Përdorimi i energjisë së avullit dhe i pajisjeve të përparuara në industri, transport, etj., përmirësuan jetën në qytete dhe quhen _____ **1 pikë**

c) Rritja e vrullshme e popullsisë urbane në vendet e Botës së Tretë është cilësuar si _____ **1 pikë**

18. Shkruani tre nga katër format kryesore sipas të cilave zhvillohen marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

19. Në përgjithësi faktorët themelorë që modelojnë një demokraci janë: **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

20. Roli i partive politike shfaqet më shumë në periudhën e zgjedhjeve. Në këtë drejtim, funksionet e partive politike janë: **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____